



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LIGJI Nr. 03/L-243**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/33  
PËR BLEGTORINË E KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Me qëllim të krijimit të kushteve ligjore që Ligji Nr.2004/33 për Blegtorinë e Kosovës të gjejë zbatueshmëri të plotë,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.  
2004/33 PËR BLEGTORINË E KOSOVËS**

**Neni 1**

1. Neni 1 i ligjit në fuqi pika a) fundi i paragrafit fjalia “**ruajtjen e racave origjinale**” ndryshohet dhe riformulohet “**ruajtjen e resurseve gjenetike vendore**”.

## **Neni 2**

1. Neni 2 i ligjit në fuqi pika a) riformulohet si vijon:

**a) Kafshë shtëpiake** - nënkupton çdo kafshë që i përket llojeve të kafshëve të cilat mbarështohen nën përkujdesjen e njeriut, duke përfshirë shpezët, peshqit dhe bletët me qëllim fitimi, konsumi ose për konsumin e prodhimeve të tyre.

2. Neni 2 i ligjit në fuqi pika b) përkufizimi “Mbarështim” pas fjalës “**dhe**” shtohet fjala “**masave**”.

## **Neni 3**

Neni 3 i ligjit në fuqi pika a) pas fjalës “**pastërt**” shtohet fjala “**Hibrideve**”.

## **Neni 4**

Neni 13 i ligjit në fuqi paragrafi 2. pas fjalës “**autorizuar**” shtohet fjala “**blegtorisë**”.

## **Neni 5**

Neni 14 i ligjit në fuqi paragrafi 2. fshihet nga teksti i ligjit.

## **Neni 6**

Titulli i Kreut VI të ligjit në fuqi “**Sanksionet Administrative**” të riformulohet “**Dispozitat Ndëshkuese**”.

## **Neni 7**

Neni 25 i ligjit në fuqi fjala “**shkelje**” të zëvendësohet me fjalën “**kundërvajtje**” ky zëvendësim vlen në tërë tekstin e këtij neni.

## **Neni 8**

Neni 27 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave ndëshkuese të këtij ligji si dhe të hyrat nga taksat, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Neni 9**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-243**  
**28 tetor 2010**

**Anëtari i Kryesisë së Kuvendit**

**Xhavit HALITI**